



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

**ZL.Anr.242/2025**

**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP)**, i përbërë nga gjyqtarët: Violeta Husaj Rugova - kryesuese, Bujar Muzaqi dhe Hajriz Hoti - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën Malësor Asllani, kandidat për asamble komunale e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) të paraqitur kundër komisionerëve të Komisionit Komunal të Zgjedhjeve (KKZ), Vushtrri, për shkak të parregullsive gjatë numërimit në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur me 20.10.2025, merr këtë:

## **V E N D I M**

**REFUZOHET e pa bazuar** ankesa ZL.Anr.242/2025, e datës 17.10.2025, e parashtruar nga Malsor Asllani, kandidat për asamble komunale e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) paraqitur kundër komisionerëve të Komisionit Komunal të Zgjedhjeve (KKZ), Vushtrri për shkak të parregullsive gjatë numërimit në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025.

## **A r s y e t i m**

Me datën 17.10.2025, PZAP-i ka pranuar ankesën e kandidatit për asamble komunale nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me të cilën pretendon se me datë 17.10.2025, kishte parregullësi gjatë procesit të numërimit të votave për kandidatë të kuvendit komunal. Kërkoj rinumërim të Qendrave: 2701 – SH.M. Bahri Haxha, 2707 – Sh.F.M.U. Abdyl Frashëri, 2718- Sh.F.M.U. Liria.

Në përgjigjen në ankesë të Komisionin Qendror të Zgjedhjeve – KQZ, theksojnë se pretendimet e palës ankuese se janë bërë parregullësi gjatë procesit të numërimit të votave

për kandidatet e kuvendit komunal, e cila ka kërkuar rinumërimin e Qendrave të Votimit:2701,2707,dhe 2718.

Bazuar në nenin 101 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP), Rregulloren Zgjedhore Nr.16/2024, Qendrat Komunale të Numërimit për Zgjedhjet Lokale 2025, e miratuar me 01.10.2025, Nr.01/2601/2025, përcaktohet procedura lidhur me procesin e numërimit në QKN.

Tutje KQZ ka theksuar se rezultatet përfundimtare të procesit zgjedhor, shpallen nga KQZ-ja pas përfundimit të numërimit të të gjitha fletëvotimeve nga vendvotimet e rregullta; fletëvotimeve nga votimit me kusht; fletëvotimet nga votimi i personave me nevoja të veçanta; fletëvotimeve nga votimi jashtë Kosovës; vendosjes për ankesat eventuale nga PZP dhe Gjykata Supreme dhe pas përfundimit të të gjitha procedurave në QNR, ku rezultati i publikuar është i ankimeshëm nga subjekte politike dhe kandidatët të cilët kanë pretendime në raport me numërimin e votave të tyre. Pra, në momentin e publikimit të rezultateve përfundimtare nga KQZ-ja, palët e pakënaqura në pajtim me nenin 105 të LPZ, pala mund të ushtrojë ankesë në afatin brenda dyzet e tetë (48) orëve në PZAP. Në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP, gjatë shqyrtimit të ankesës është vërejtur se pala ankuese nuk ka bashkëngjitur prova të mjaftueshme që do të mund të dëshmonin apo mbështesin pretendimet e tij të paraqitura në ankesë.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës - PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë gjeti se:

**- Ankesa është e pa bazuar**

Paneli i PZAP-së i vlerësoj pretendimet ankimore të Malsor Asllani kandidat për Asamble Komunale nga subjekti politik i PDK në Vushtrri, se me datë 17.10.2025, gjatë procesit të numërimit të votave për kandidatë të kuvendit komunal, duhet të numërohen QV në 2701,2707 dhe 2718, por Paneli vlerësoi se pretendimet janë të pabazuara pasi që ankuesi nuk ka dëshmuar me prova konkrete pretendimet e tij edhe pse i referohet parregullsive gjatë numërimit të votave.

Bazuar në arsyet e sipërsëhënuara dhe në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së i cili parasheh se *“PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin kriteret e miratuara paraprakisht”* dhe Neni 13 paragrafi 4 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, në të cilin përcaktohet se: *“PZAP-i mund në përgjithësi të refuzoj një ankesë apo grup ankesash nëse ato nuk paraqesin raste prima facie ose ku ankesa apo grupi i ankesave është dukshëm i pabazë”*, lidhur me ankesën e lartë përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

ZLAnr.242/2025 më datën 20.10.2025



**Këshilla Juridike:** *Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.*